



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 15

Datë: 15. 03. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 10:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 14/2024**
- 3. Aktivitetet e SKQZ**
- 4. Aktivitetet e Zyrës**

- Raporti njoftues për pranimin e Raporteve vjetore financiare 2023, të dorëzuara nga subjektet politike

- 5. Raport i Këshillave të KQZ**

5.1.Këshilli për Personel

Njoftim lidhur me shqyrtimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2025-2027

5.2.Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Njoftim lidhur me shqyrtimin e Shqyrtimi e Kornizës Afatmesme te Shpenzimeve për vitet 2025-2027

-Analizë e moshës dhe gjinisë për vëzhguesit e subjekteve politike në Zgjedhjet e vitit 2021

5.3.Këshilli për Buxhet dhe Financa

- Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme te Shpenzimeve për vitet 2025-2027

6. **Shqyrtimi dhe miratimi i formimit të Këshillit Mbikëqyrës për IP, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut**
7. **Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës së IDEA për të marrë pjesë në Konferencë “Roli i inteligjencës artificiale në proceset zgjedhore?”, që do të zhvillohet në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë më 16 prill 2024**
8. **Të ndryshme !**

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari **Radoniqi**, hapi takimin e 15-të të këtij viti, fillimisht ai tha se në këtë takim mungon me arsye anëtari Qemajl Kurtis për shkak të bllokimit të rrugës, ndërsa pastaj e paraqiti agjendën e takimit.

Anëtarët e KQZ-së, me 10 vota për, e miratuan agjendën.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 14/2024:

Në vazhdim, me 10 vota për, u miratua edhe procesverbali, ndërkohë që u kalua në aktivitetet e Sekretariatit.

3. Aktivitetet e SKQZ:

Burim Ahmetaj, e informoi KQZ-në lidhur me aktivitetet e Sekretariatit mes dy mbledhjeve. Ai tha se, më 10 mars 2024, u është dërguar ftesa Partive Politike për propozimin e Anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviç, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut, që do të mbahët më 21 Prill 2024. Nominimet,

sipas ftesës duhet të dorëzohen në mënyrë fizike në zyrat e KKZ-ve ose në Sekretariatit e KQZ-së deri më datë: 15 mars 2024 në orën 16:00. Sekretariati, i trajton nominimet në bazë të kriterëve që përcaktohen në Rregulloren Zgjedhore Nr.02/2024 dhe kapitullin XI, nenin 69 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës për tu shqyrtuar dhe miratuar nga KQZ me datë 17 mars 2024.

Me qëllim të saktësimit të listës së votuesve dhe konfirmimit të të drejtës për votim, Sekretariati, bazuar në Ligjin Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 8 paragrafi 1, kërkon nga Departamenti i Gjendjes Civile që të përgatisë ekstraktin e Regjistrit Qendror Civil, me të dhënat e të gjithë shtetasve për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, të cilët janë të moshës 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç, duke përfshirë edhe personat që deri me datën 30 qershor 2024, mbushin moshën 18 vjeç.

Kërkesa për Ekstrakt duhet të jetë i gatshëm për praninë nga KQZ, me datën 14.03.2024 (ditë e enjte), deri në orën 13:00.

Përmes këtij raporti, Ahmetaj e informoi KQZ-në se më 11.03.2024, Sekretariati ka kërkuar që lidhur me mbështetjen e nevojshme të KKZ-ve në kuptimin e sigurimit të hapësirave për punë, të sigurohen zyre të mjaftueshme për punën e ZE, të KKZ-ve, hapësirë për trajnimin e trajnerëve për KVV-të dhe të stafit tjetër të angazhuar për këtë proces të votimit, kuptohet brenda hapësirave të administratës komunale. Deri me tani, tha Ahmetaj, kemi pranuar përgjigje pozitive nga Komuna e Mitrovicës së Veriut e cila, e ka siguruar një zyre me një hapësirë për 4 zyrtarë në objektin e komunës.

Nga raporti, u bënë i ditur edhe plani i aktiviteteve të procesit të votimit të cilat janë në zhvillim e sipër dhe ato të cilat, pritet të fillojnë: 1. Emërimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve bëhet më 17 mars 2024. 2. KQZ, angazhohet që ta miratojë raportin e Listës Preliminare të Votuesve më, 18 mars 2024. 3. Publikimi i Listës Preliminare të Votuesve fillon më 18 mars, dhe përfundon më 19 mars 2024. 4. Miratimi i Qendrave të Votimit nga KQZ fillon më 15 mars, dhe përfundon më 16 mars 2024. 5. Publikimi i listës së Qendrave të Votimit, bëhet jo më vonë se 16 mars 2024. 6. Periudha për ndërrimin e Qendrës së Votimit brenda komunës fillon më 18 mars, dhe përfundon më 3 prill 2024. 7. Afati për Kundërshtimin dhe Konfirmimin e Listës së Votuesve fillon më 18 mars, dhe përfundon më 5 prill 2024. 8. KQZ themelon Komisionin për Kundërshtimin Administrativ për shqyrtimin e ankesave për refuzimin e regjistrimit si votues jashtë Kosovës, që fillon më 17 mars, dhe përfundon më 05 prill, 2024.

Ndër aktivitetet e tjera të Sekretariatit, e që nuk lidhen me votimin aktual të "21 Prillit", Ahmetaj tha se Sekretariati i ka drejtuar një kërkesë komunës së Lipjanit për sigurimin e zyrës për KKZ dhe depo, meqë kjo komunë ka kërkuar nga KQZ që ta lirojë zyrën e KKZ-së, dhe depon që ne i kemi në shfrytëzim. Objekti

komunal, do të rrënohet! Pra, ne kemi kërkuar që kjo komunë, të përmbushë obligimin dhe të sigurojë hapësirë për KKZ-në atje, sepse ka detyrim ligjorë, bazuar në nenin Neni 68, paragrafi 5 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme Nr.08/L-228.

Në këtë pikë, u shtruan pyetje, u bënë shqyrtime, si dhe u dhanë propozime etj., lidhur me raportin nga: Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Arianit Elshani, Ilir Gashi dhe, Alban Krasniqi (i cili, në analizën e tij raportit, në kontekst, kërkoi organizimin e një takimi me subjektet politike që marrin pjesë në këtë votim). Ekuivalent me debatin mbi këtë raport, anëtarët e KQZ-së u interesuan kryesisht në lidhje me aspektin përgatitorë – organizativ të votimit të “21 Prillit” brenda Sekretariatit, si dhe në relacion me komunikimin, bashkëpunimin dhe me koordinimin e faktorëve relevantë.

Pas shqyrtimit të gjerë të këtij raporti të aktivitetet të Sekretariatit, lidhur me rekomandimin, kryetari Radoniqi pyeti anëtarët e KQZ-së se, a ka dikush diçka...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan themelimin e Komisionit me 8 vota për, dhe 2 abstenime (Ilir Gashi, Arianit Elshani) në përbërje: Emira Alushi, kryesuese, Lirik Krasniqi, anëtarë dhe Valbona Kida, anëtare.

4. Aktivitetet e Zyrës

Raporti njoftues për pranimin e Raporteve vjetore financiare 2023, të dorëzuara nga subjektet politike:

Besnik Buzhala, drejtues i Zyrës, tha se sipas ligjit për financim të partive, deri në fund të marsit, partitë janë të obliguara për dorësimin e raportit vjetorë. Zyra, ka pranuar deri më tani 51 raporte. Ndërsa, 3 parti nuk kanë dërguar raporte vjetore funanciare. Këto janë: PSHDK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës, dhe partia Ekologjike e Gjellbërt e Kosovës.

Për këto tri parti, Zyra ka shqiptuar dënime me nga 4000 euro për secilën. Gjoha, përfshihet si dispozitë ndëshkuese, tha Buzhala.

Zyra, ka shqyrtuar edhe donacionet gjatë vitit 2023. Nga inspektimi i Zyrës, ka dalë që 3 parti kanë pranuar kontribute në të holla, në kundërshtim me ligjin dhe zyra, ka ingerenca që ti sinjalizoj partitë për këto shkelje në kundërshtim me ligjin. Nga këto, janë: Lëvizja për Bashkim, ka pranuar nga një individ donacion më shumë se 2000 euro, sa lejohej me ligj. Balli Kombëtar, dhe një parti turke, kanë pranuar donacion, përtej asaj që lejon ligji.

Ibrahim Selmanaj, pyeti se nëse një subjekti Zyra i shqipton dënim dhe subjekti nuk i përgjigjet, cilat janë masat tjera.

Besnik Buzhala tha se, subjekti ka të drejtë ankse në shkallën e parë, brenda 5 ditëve nga shqiptimi i gjobës. Mirëpo, ne u kemi dhënë afat prej 30 ditë që, këto subjekte ta paguajnë gjobën. Mos pagimi, apo ngjashëm, nga Zyra realizohet përmes procedurave përmbaruese. Por, është edhe privimi i subjektit që, nëse nuk e kryen obligimin e gjobës, nuk mund të marrë pjesë në zgjedhje...

Alban Krasniqi, tha se pavarësisht, do të duhej që edhe më shumë tu qartësohet subjekteve se, kryerja e obligimeve, është e patjetërsueshme. Pra, obligimet janë ligjore, dhe ato nuk mund të funksionojnë, edhe nëse për shembull, nuk merr pjesë në zgjedhje. Paratë e dyshimta, e ky është edhe problem i BE-së, vijnë edhe në Kosovë dhe Zyra, duhet t'i ashpërsoj masat. Një subjekt, mund të mos e ketë shumë për problem pjesëmarrjen në zgjedhje, se mund të ketë edhe agjenda tjera...

Sami Kruteshi, pyeti se çka ka ngja me ndryshimin e Iniciativave Qytetare, në Parti Politike...?

Buzhala, tha se ato nisma, organizata që fitojnë ulëse në Parlament, janë të obliguara që të regjistrohen si subjekte politike. Ne, i kemi paralajmëruar ato, tashmë. **Gordna Llaban**, pyeti se a është bërë kjo, kur...? Që nga data 6 mars, kur është miratuar rregulla zgjedhore, tha Buzhala, zyra i ka lajmëruar, dhe afati është 60 ditë që të regjistrohen si parti.

5. Raport i Këshillave të KQZ

1.Këshilli për Personel

Njoftim lidhur me shqyrtimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2025-2027:

Alban Krasniqi, tha se këshilli ka shqyrtuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2025-2027, kjo për dy procese zgjedhore. Projektionet që janë sjellë nga Sekretariati, i kemi analizuar e shqyrtuar në këshill. Planifikohet që përgjatë vitit të ardhëm zgjedhor 2025, si për zgjedhjet Lokale (për fshi edhe raundin e Dytë), dhe ati Parlamentare, të jenë të angazhuar. Për Zgjedhjet Parlamentare: 234 persona (Sekretariat/KQZ), për nevojat e QKN/KKZ – 516 persona që duhet angazhuar. Si trupa direkt të përfshirë, brenda KVV/QKN, angazhohen: 23, 180 persona. Në total, parashihet t'i angazhohjmë: 23930 persona. Kostoja totale e planifikuar, e angazhimit të këtij stafi, kap shumën: 4 milion, e 381 mijë euro.

Për zgjedhjet Lokale, numri total parashihet të jetë: 23, 920 persona. Kostoja: 8 milion, 715 mijë euro.

Të total, për dy palë zgjedhjet, parashihen të jetë kostoja prej: 13 milion euro – përkufizim i planifikuar, që edhe mund të ndryshoj...!

Krasniqi, foli edhe rreth procedurave, organizimit, mënyrës së angazhimit etj.

Në këtë pikë, shtruan pyetje, diskutuan: Sami Kurteshi, Ibrahim Selmanaj, i cili pyeti se a janë parapa mjete edhe për votimin me jashtë, trupat menaxhuese që duhet të angazhohen jashtë vendit...! Krasniqi, tha se po, edhe kjo është mendue, por nuk mund të thuhet se edhe është e saktësuar e gjitha...

2.Këshilli për Operacione Zgjedhore

Njoftim lidhur me shqyrtimin e Shqyrtimi e Kornizës Afatmesme te Shpenzimeve për vitet 2025-2027:

Arianit Elshani, tha se KOZ-i ka trajtuar secilin aktivitet përmes së cilit planifikim buxhetor. Disa planifikime për disa kategori, i kemi ulur, e disa aktivitete edhe të fuzionohen, si dhe disa shuma të shprëndara, i kemi fuzionuar mes disa aktiviteteve që ndër – përfshihen. Mendoj që, ky është një prej viteve më së miri të planifikuara.

Pra, insistojmë që Sekretariati, të mos krijoj konfuzion dhe ngjashëm, por të bëj planifikime thjeshtë, të qarta për secilin...

Si KOZ, rekomandojmë për aprovim të kësaj kornize.

3.Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme te Shpenzimeve për vitet 2025-2027:

Gordana Llaban, tha se këshilli, ka shqyrtuar kornizën Afatmesme te Shpenzimeve për vitet 2025-2027, e cila, për vitin 2005 kap shumën: 22,793, 770, 0,91 euro. Znj. Llaban, pasqyrooi ndarjet buxhetore sipas kategorive: për shpenzime të Sekretariatit: 2, 392, 121, 0, 22 euro, për Zgjedhje: 15, 684, 90, 0,69 euro, dhe për fondin e Demokratizimit: 4, 900,000 euro.

Rekomandojmë për aprovim.

Sami Hamiti, tha se korniza është trajtuar maksimalisht, në detaje. Por, është kjo shumë se janë dy palë zgjedhje. Diskutuan, edhe Ilir Gashi, Alban Krasniq.

Në fund, anëtarët e KQZ-së me 9 vota për, miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitet 2025-2027:

Analizë e moshës dhe gjinisë për vëzhguesit e subjekteve politike në Zgjedhjet e vitit 2021:

Arianit Elshani, tha se ky dokument KOZ ka kërkuar që të tërhiqet për çështje dizajni. Ai e informoi KQZ-në, lidhur me përmbajtjen e analizës: pjesëmarrjen, moshën, gjininë e vëzhguesve. Përqindjen e pjesëmarrjes... Ai, theksoi se kjo është hera e parë që KQZ gjeneron një analizë të këtillë. Rekomandojmë të aprovohet.

Në këtë pikë, diskutuan: **Gordana Llaban**, që tha se edhe më shumë KQZ-të apeloj që gratë, të angazhohen edhe më shumë në proceset politike, dhe ngjashëm. Pastaj, diskutoi edhe Sami Kurteshi, i cili e vlerësoi raportin, por kërkoi që raporti të plotësohet me “qëllimin” dhe, tha se kjo mungon në raport. Por, duhet të nxirren edhe rekomandimet e raportit. Diskutoi edhe: Alban Krasniqi.

Në fund, me ndryshimet dhe komentet që u dhanë, me 9 vota për u miratua Analiza e Moshës dhe e Gjinisë për Vëzhguesit e Subjekteve Politike në Zgjedhjet e vitit 2021.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i formimit të Këshillit Mbikëqyrës për IP, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Alban Krasniqi, tha se është KOZ dhe, pse të formohet ky komision. KOZ-i, merret me këto çështje, dhe ndoshta Fazliu, mund të jetë ndërmjetës mes IP dhe KQZ. Pra, Fali Stollaj u propozua që nga KOZ të angazhohet lidhur me Informimin Publik për këto zgjedhje...

7. Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës së IDEA për të marrë pjesë në Konferencë “Roli i inteligjencës artificiale në proceset zgjedhore?”, që do të zhvillohet në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë më 16 prill 2024:

Kreshnik Radoniqi, e informoi KQZ-në për një ftesë e ardhur nga Republika e Bosnje dhe Hercegovinës. Kurse, **Burim Ahmetaj** tha se fjala është për një ngjarje me 16 prill, konferencë me temën “Roli i inteligjencës artificiale në proceset zgjedhore?” që organizohet nga IDEA. Nevojitet konfirmim. Mbulimi i shpenzimeve bëhet nga kjo organizatë.

Kreshnik Radoniqi, tha se ftesa, është për mua, por unë nuk mund të shkoj....

Në fund, u vendos që, të udhëtojnë: Kreshnik Spahiu. Por nëse shkojnë dy persona, u ra dokarod që të udhëtoj edhe Fazli Stollaj...

8. Të ndryshme !

Alban Krasniqi: Çështja e vlerësimit të Zëdhënësit, është kryer. Vlerësimi, është bërë. Dhe se, bartja e formularëve është në Personel. Zyrtarja, le të referoj...

Më tej, vlerësimi ma nuk bëhet në mbledhje...